



Republika e Shqipërisë
Universiteti i Sporteve të Tiranës

PRAKTIKË PËR PËRJASHTIM 50% NGA PAGESA E TARIFËS SË SHKOLLIMIT
PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS –
ME KOHË TË PLOTË

Nr. _____ Prot. _____
Datë _____

Kërkesa plotësohet në bazë të: VKM Nr. 780, datë 26.12.2018”Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve , në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES

(Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjën X ose rrumbullako)

Emri		Datëlindja	___ / ___ / _____	
Atësia		Nr. i letërnjoftimit		
Mbiemri		Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>
Fakulteti/ Programi i studimit	FSHL -Shkencat e Levizjes	FVFR -Shkencat e Veprimtarisë fizike dhe Rekreacionit	Cikli i studimit	II
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Viti i studimit	MP MSH
Përrjashtim 50 % nga Tarifa Shkollimit				

Unë kërkuesi paraqes **KËRKESE** për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, pasi jam student në UST dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi që rregullojnë tarifën vjetore të shkollimit në IAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë, si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kushteve të renditura në vijim janë në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumente zyrtare të marra në institucionet shtetërore të njohura me ligj. Shpreh dakortësinë time për përpunimin dhe verifikimin e të dhënave personale të mia.

Jam në dijeni se deklarimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumenteve të fallsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit dhe më detyron të kryej pagesën e kësaj tarife sipas afateve të përcaktuar në njoftimin e bërë nga strukturat e UST-së.

Dokumentet shoqërues janë origjinal ose kopje të noterizuara.

Kriteri 1 Student që vjen nga shtresa sociale: student me aftësi të kufizuara të vërtetuara me Vendim KMCA

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e Vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA);
- Vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë që merr studentin
- Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës
- Fotokopje e noterizuar e statusit të paraplegjikut/ teraplegjikut
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 2 Student që vjen nga shtresa sociale: student fëmijë të përonave/familjes me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me Vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga Ligji nr.9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmën ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti vetëqeverisjes vendore.

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

- Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCA-së (Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) për studentin me prindër me aftësi të kufizuar (invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik);
- Vërtetim që lëshon shoqata e invalidëve të punës së rrethit përkatës së bashku me fotokopjen me vulë të njomë të Dëshmisë së Invalidit të Punës të përfituar sipas statusit të invalidit të punë
- Vërtetim original i Institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit
- **Vërtetim origjinal për trajtim/përfitim ndihme ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti e vetëqeverisjes vendore;**(Vërtetimi duhet të jetë me numër protokoli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur)
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 3 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësiti bazë të vetëqeverisjes vendore.

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

- Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në lidhje me masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja. (Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar **numrin e dosjes** dhe të jetë shënuar qartë **shuma e ndihmës ekonomike** (me shifra dhe me fjalë), si dhe masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme). Vërtetimi duhet të jetë me numër protokoli, të jetë nënshkruar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 4 Student që vjen nga shtresa sociale: Student deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, të ardhurat vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve.

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

- Çertifikatë vdekjeje e prindit që u është ndarë nga jeta ;
- **Vërtetime që vërtetojnë të ardhurat vjetore të familjes, si më poshtë:**

- Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që familja përfiton ndihmë ekonomike si familje në nevojë;
ose
 - Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që asnjë nga familjarët e studentit (personat mbi 18 vjec) nuk ushtrojnë aktivitet privat;
 - Vërtetime nëse prindërit apo ndonjë pjesëtar i familjes mbi 18 vjec janë të regjistruar si punëkërkues të papunë (nga zyra e punës);
 - **Vërtetim familjarisht** nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (nëse përfitojnë pension ose jo).
 - Vërtetim nëse familjarët kanë tokë ose pasuri të paluajtshme fitimprurëse në pronësi;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 5 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e librezës për përfitimin e statusit të jetimit lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror,
- Çertifikatë vdekje që vërteton që ka humbur të dy prindërit.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 6 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë.

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të formës së prerë të gjykatës për humbjen e kujdestarisë prindërore **ose** është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton **ose** Dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 7 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qënieve njërzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajnim si viktima të trafikut të qënieve njerëzore.

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se kanë përfituar statusin ligjor për trajnim si viktima të trafikut të qënieve njërzore, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 8 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe mbrotjes.

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se student është fëmijë të punjonjësve të të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, lëshuar nga ministria përkatëse;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 9 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët romë / ballkano – egjiptianë.

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se student i përket komunitetit romë dhe ballkano-egjiptianë lëshuar nga ministria përgjegjëse për mirëqënien sociale
- Deklaratë noteriale;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 10 Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të ish- të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

- Vërtetimi i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
- Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga ministria e punëve të brendshme.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

Kriteri 11 Student që rezultojnë me notë mesatare vjetore 9(nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës

- Konfirmohen me listë nga sekretaria sipas fakulteteve

KËRKUESI

Emri Mbiemri nënshkrimi